



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1204 Prot.

Tiranë, më datë 12.09 2023

VENDIM

Nr. 495, datë 12.09.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.09.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimit të kërkimeve arkeologjike në kuadër të projektit në vazhdim “Durrësi Mesjetar-Amfiteatri”, me drejtues projekti **Dr. Elvana Metalla** dhe zhvillues **Akademia e Studimeve Albanologjike**;
2. Para fillimit të projektit të bëhet njoftimi zyrtar pranë IKTK-së dhe DRTK-së përkatëse;
3. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së dhe IKRTK-së;
4. Dokumentacioni i hartuar në kuadër të këtij projekti për vitin 2023 të dorëzohet pranë IKTK-së;
5. Afati përfundimtar i punimeve është një vit nga miratimi në KKTKM;
6. Afati përfundimtar i punëve do të jetë sipas planit të punës të depozituar në IKTK;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

KRYETAR  
Elva MARGARITI

